

SHOQËRIA KONÇENSIONARE MARINA VLORË SH.P.K
LOBBY HOME, RRUGA NACIONALE TIRANË – ELBASAN LUNDER FARKË , TIRANË
M12027029I

VENDIM

I

ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË

Sot, me 04.05.2023 (dy mijë e njëzet e tre) ne oren 11:00 ne seline e "Shoqërisë Konçensionare Marina Vlorë" Sh.p.k (me tej referuar si "Shoqëria"), mbahet mbledhja e Asamblese se Pergjithshme te Shoqerise. Jane te pranishem palet e meposhtme ortake te Shoqerise, konkretisht:

"MARINA DI VALONA" sh.p.k. një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar pranë Qëndres Kombëtare të Biznesit me NUIS M01324008A me seli në adresën: "Tirane Farke Lunder Lobby Home, Rruga Nacionale Tirane- Elbasan, Perballe Qendres Tregtare TEG", përfaqësuar nga administratori Eranda Muskaj, - ortak i Shoqërisë dhe zotërues e 99.9999 % e kuotave të kapitalit themeltar të saj;

"BRUNES" sh.p.k. një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar pranë Qëndres Kombëtare të Biznesit me NUIS K37125203H me seli në adresën: "Tirane, Kashar, Autostrada Tirane-Durres, Km.7, ZK.2105, Ndertesa me Nr.Pasurie 187/23 dhe Nr.Pasurie 187/24" , përfaqësuar nga administratori Geront Çela, - ortak i Shoqërisë dhe zotërues e 0.0001 % e kuotave të kapitalit themeltar të saj;

Z.Geront Çela, merr drejtimin e mbledhjes në cilësinë e Kryetarit dhe fton Eranda Muskaj te kryej detyrën e Sekretares se Mbledhjes se Asamblesë se Ortakeve deklaron vullnetin e ortakëve për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, pavarësisht mungesës së njoftimit për thirrjen e asamblesë, e deklaron Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dyte të nenit 83 të Ligjit n. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim:

Rendi i Ditës

- I. Zmadhimi i Kapitalit të Shoqërisë "Shoqëria Konçensionare Marina Vlorë" sh.p.k;
- II. Miratimi i injektimit të një vlere prej 172,000,000 (njëqind e shtatëdhjetë e dy milion lekë) në formën e kontributit monetar në kapitalin e Shoqërisë "MARINA DI VALONA" sh.p.k, e cila duke injektuar këtë kapital në Shoqërinë "Shoqëria Konçensionare Marina Vlorë" sh.p.k, rrit përqindjen e kuotës së saj në kapitalin e kësaj të fundit te barazvlefshme me 99,9999 % (nëntëdhjetë e nëntë pikë nëntëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë përqind);
- III. Miratimi i përqindjeve respektive të ndryshuara për secilin ortak pas miratimit të kapitalit shtesë të rritur të injektuar nga Shoqëria "MARINA DI VALONA" sh.p.k si më poshtë nga secili ortak;
- IV. Të ndryshme;

* * * * *



Në lidhje me pikat në Rend të Ditës, Kryetari parashtron se kapitali i shoqërisë është 370,001,000 Lekë (treqind e shtatëdhjetë milion e një mijë lekë), përkatësisht shoqëria MARINA DI VALONA sh.p.k ka kontribuar kapital shumë 370,000,500 Lekë (treqind e shtatëdhjetë milion e pesëqind lekë) e barazvlefshme me 99,9999% (nëntëdhjetë e nëntë pikë nëntëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë përqind) dhe BRUNES sh.p.k ka kontribuar në kapital 500 Lekë (pesëqind lekë) e barazvlefshme me 0.0001%.

Në kuadrin e realizimit nga shoqëria "Shoqëria Konçensionare Marina Vlorë" sh.p.k e investimit të projektit "Porti i Jahteve Marina Vlorë" Kryetari i Asamblesë parashtron domosdoshmërinë e injektimit të likujditeve në kapitalin e Shoqërisë.

Përsa më sipër, Ortakët dëshirojnë të zmadhojnë kapitalin e shoqërisë dhe Ortaku shoqëria "MARINA DI VALONA" sh.p.k ka shprehur interes të paguajë zmadhimin e kapitalit nëpërmjet kontributit në para me një vlerë prej 172,000,000 Lekë (njëqind e shtatëdhjetë e dy milion lekë) ("Zmadhimi i Kapitalit"). Propozohet që Zmadhimi i Kapitalit të nënshkruhet nga Ortaku shoqëria "MARINA DI VALONA" sh.p.k dhe të shlyhet jo më vonë se data 31 Dhjetor 2023 (dy mijë e njëzet e tre).

Në përputhje me Statusin e Shoqërisë dhe pas një shqyrtimi të kujdesshëm të çështjes në Rend të Ditës, Asambleja e Pergjithshme e Shoqërisë:

VENDOSI:

- A. Të miratojnë zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë nëpërmjet kontributit në para në vlerën prej 172.000.000 lek (njëqind e shtatëdhjetë e dy milion lekë) ("Zmadhimi i Kapitalit").
- B. Ky kontribut financiar i shtuar në Kapitalin e shoqërisë do të injektohet nga ortaku i Shoqërisë, shoqëria "MARINA DI VALONA" sh.p.k.
- C. Zmadhimi i Kapitalit do të shlyhet jo më vonë se data 31 Dhjetor 2023 (dy mijë e njëzet e tre).
- D. Pasi Zmadhimi i Kapitalit të jetë shlyer tërësisht nga Ortaku shoqëria "MARINA DI VALONA" sh.p.k sipas pikës (C) më sipër, kapitali i Shoqërisë nga 370,001,000 LEK (treqind e shtatëdhjetë milion e njëmijë lekë) do të bëhet 542,001,000 Lekë (pesëqind e dyzetë e dy milion e njëmijë lekë);
- E. Duke u nisur nga kontributet:
 - a. Ortaku MARINA DI VALONA sh.p.k do të zotërojë një kuotë në vlerën prej 542,000,500 Lekë (pesëqind e dyzetë e dy milion e pesëqind lekë) të barazvlefshme me 99.9999% te kapitalit të Shoqërisë;
 - b. Ortaku Brunnes sh.p.k do të zotërojë një kuotë në vlerën 500 Lekë (pesëqind lekë) të barazvlefshme me 0.0001 % te kapitalit të Shoqërisë.
- F. Të autorizojë administratorin në detyrë që në emër dhe për llogari të Shoqërisë të kryejë gjitha aplikimet e nevojshme me qëllim regjistrimin në Qendren Kombëtare të Biznesit nëpërmjet platformës online e- albania , personalisht ose nëpërmjet autorizimit të personave të tjerë për këtë qëllim.



* * * * *



Meqënëse nuk pati asnjë çështje tjetër për të diskutuar, Kryetari e deklaroi mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë të mbyllur në orën 12:30. Ky Vendim i Shoqërisë, i mbajtur në formën e procesverbalit, nënshkruhet rregullisht në përputhje me parashikimet e nenit 90/3 të Ligjit nr. 9901., datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, nga Sekretari dhe Kryetari i Mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE TË SHOQËRISË
"SHOQËRIA KONÇENSIONARE MARINA VLORË" SH.P.K

KYETARI
BRUNES SH.P.K



ADMINISTRATOR I SHOQËRISË
MARINA DI VALONA SH.P.K

